



Komuna e Deçanit
Drejtoria e Arsimit



Mundësi të barabarta në arsim për të gjithë

EKIPET PËR PARANDALIM DHE REAGIM
NDAJ BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT
NË ARSIMIN E OBLIGUAR

**Të gjithë së
bashku kundër
braktisjes së
mësimit**

Për informata më të hollësishme:

<https://masht.rks-gov.net/mundesi-te-barabarta-ne-arsim-per-te-gjithe>

Informata

Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë
Drejtoria Komunale e Arsimit-Deçan
e-mail: Ramiz.Bajramaj@rks-gov.net
ADRESA : Rr. " Jashar SALIHU "Nr.51000
Deçan Republika e Kosovës

E DREJTA PËR SHKOLLIM

E drejta për shkollim është e garantuar me:

- Konventa ndërkombëtare
- Kushtetutë
- Ligji nacional
- Doracakët
- Planet strategjike etj.

ME QËLLIM TË PARANDALIMIT TË BRAKTISJES SË SHKOLLËS JANË THEMELUAR EKIPE ADEKUATE PËR KËTË PROBLEMATIKË

Ekipi për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit- EPRBM

- EPRBM NË NIVEL SHKOLLE
- EPRBM NË NIVEL KOMUNE (DKA)
- EPRBM NË NIVEL NACIONAL (MASHT)



EPRBM PËRDORIN TË GJITHË MEKANIZMAT DHE MUNDËSITË PËR TË:

- Identifikuar
- Parandaluar
- Raportuar
- Referuar
- Trajtuar me efikasitet predispozitat dhe rastet e braktisjes

KËSHILLI DREJTUES I SHKOLLËS THEMELON EPRMB NË NIVEL SHKOLLE NË PËRBËRJE TË:

- Drejtorit të shkollës
- Një përfaqësues i nxënësve
- Një përfaqësues i prindërve
- Një përfaqësues i mësimdhënësve
- Sipas nevojë edhe ekspert shtesë.

Rastet fillimisht trajtohen në nivel shkollë pastaj raportojnë në nivel komune, e komuna i raporton Masht-it.

DKA THEMELON EPRMB NË NIVEL KOMUNAL PËRBËRJE TË:

- Dy përfaqësues nga DKA
- Një përfaqësues nga Këshilli i Prindërve
- Një përfaqësues i mësimdhënësve
- Një përfaqësues i Këshillit të nxënësve
- Një drejtor shkollë
- Një përfaqësues i drejtorive për mirëqenje sociale, shëndetësi, ZKKK,
- Ekspert i gjithëpërfshirjes në arsim nga shoqëria civile

CILI ËSHTË PROFILI I FËMIJËVE QË JANË NË RREZIK TË BRAKTISJES SË SHKOLLËS?

Fëmijët që janë në rrezik për braktisje të shkollës janë shpesh:

- Fëmijë me probleme të ndryshme individuale, familjare e sociale
- Fëmijë me sëmundje kronike ose lëngime të gjata
- Fëmijë që punojnë ose të involvuar në dukuri negative (narkomani, trafikim, që eksploatohen për punë të detyrueshme etj.)

CILI ËSHTË PROFILI I FËMIJËVE QË KANË BRAKTISUR SHKOLLËN?

Fëmijët që kanë braktisur shkollën janë shpesh:

- Fëmijët familjet e të cilëve nuk e dinë vlerën e arsimit,
- Fëmijët e ndikuar nga rreziqet e udhëtimit, mungesa e transportit, sëmundjet
- Fëmijët e përfshirë në martesë të hershme,
- Fëmijët e ndikuar nga varfëria,
- Fëmijët me nivel të ulët të arritshmërisë në mësimnxënie,
- Fëmijët si viktimë të dhunës dhe të dukurive tjera negative.

KUR TË REFEROHEN RASTET E FËMIJËVE NË DREJTORINË KOMUNALE TË ARSIMIT, NË QENDËR PËR PUNË SOCIALE DHE NE INSTITUCIONE TJERA RELEVANTE?

EPRBM-të e shkollave i referojnë rastet më komplekse në Qendrën për punë sociale dhe DKA/ EPRBM-në komunale.

EPRBM-të e shkollës mund t'i identifikojnë rastet e fëmijëve që i nënshtrohen dhunës, abuzimit, braktisjes ose eksploatimit (përfshirë dhunën fizike dhe seksuale, abuzimin emocional, punën e fëmijëve, lypje lëmoshe, trafikimin). Këto raste duhet të raportohen në Qendrën për Punë Sociale për veprime të mëtutjeshme. Referimi i menjëhershëm në Qendrën për Punë Sociale duhet të bëhet kur fëmija gjendet në rrezik të drjtëpërdrejtë. Kur rastet i referohen akterëve të jashtëm, shkolla vazhdon të punojë në aspektin arsimor të rastit, ndërsa për aspektet e tjera kujdesen profesionistët e kualifikuar dhe autoritetet përgjegjëse.